

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes Medina Brahaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Cc:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave, MAPL	Datë: 15.05.2019 Nr.-VI-0-524
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes	
Lloji i aktit:	Rregullore e punës së Kuvendit të Komunës dhe komiteteve	

I nderuar Kryetar,
E nderuar Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullorja Npi-01/114 e punës së kuvendit dhe komiteteve me ndryshime sipas vendimit të kuvendit numër Npi-01/115 datë 26.04.2019.

I miratuar më datë: 26.04.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.05.2019


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Rregullorja Npi-01/114 e punës së kuvendit dhe komiteteve me ndryshime sipas vendimit të kuvendit numër Npi-01/115 datë 26.04.2019.	<p>Shkelja e evidentuar – Neni 3.4, e rregullores: Njoftimet publike duhet të shpallen në të njëjtën kohë në mjetet e informimit duke u bazuar në Udhëzimin Nr.2008/09 për transparencë në Komuna.</p> <p>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë – Kuvendi duhet ta rishqyrtoj dhe të thirret në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për transparencë në Komuna.</p> <p>Shkelja e evidentuar – Neni 3.4, mbledhjet e kuvendit anëtarët e kuvendit duhet të njoftohen 7 ditë pune para çdo mbledhje të kuvendit ekskluzivisht 3 ditë pune më herët në rastet urgjente.</p> <p>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë – Ky nen i rregullores duhet të harmonizohet me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale përkatësisht Nenin 43 që ka të bëjë me mbledhjet e kuvendit të komunës dhe Nenin 44 për takimet e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës. Po ashtu të harmonizohet edhe me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës përkatësisht Nenin 5 pika 5.3 për mbledhjet e rregullta, Nenin 6 pika 6.5 për mbledhjet e jashtëzakonshme si dhe Nenin 7 për mbledhjet urgjente.</p> <p>Shkelja e evidentuar – Neni 3.13, neni 6.3 dhe neni 6.10 i rregullores përdorët termi grup parlamentar</p> <p>Kërkesa për rishqyrtim të ligjshmërisë - Ligji Nr.03/1-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nuk e njeh emërtimin grup parlamentar. Ky term të zëvendësohet me termin subjekt politikë ashtu siç është përcaktuar në ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Pejës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenanta u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a, Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a,	
Od:	Venera Çerkini, rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanja opština, MALS	Datum, 15.05.2019.
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Štimlje	Br.VI-0-524
Vrsta akta:	Odluka skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Poslovník Npi-01/114 o radu Skupštine i odbora sa izmenama prema Odluci skupštine br. Npi-01/115 od dana, 26.04.2019.

Usvojena dana, 09.03.2018. godine,

Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 14.03.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisane u aktu opštine	Zakonske odredbe sa kojima je akt opštine u suprotnosti.
1.	Poslovnik Npi-01/114 o radu Skupštine i odbora sa izmenama prema Odluci skupštine br. Npi-01/115 od dana, 26.04.2019.	<p>Evidentirano kršenje - član 3.4, pravilnika: javna obaveštenja treba da se objavljuju istovremano i u sredstvima informisanja na osnovu Administrativnog uputstva br.2008/09 o transparentnosti u opštinama.</p> <p>Kahtev ta razmatranje akta - Skupština treba da revidira i da se poziva na Administrativno uputstvo MALS-a br.04/2018 o transparentnosti u opštinama.</p> <p>Evidentirano kršenje - član 3.4, za održavanje sednice Skupštine opštine, članovi SO-a treba da se informišu sedam (7) radnih dana pre održavanja sednice i ekskluzivno tri (3) radna dana pre sazivanja u urgentnim slučajevima.</p> <p>Zahtev za razmatranje zakonitosti -</p> <p>Ovaj član Poslovnika treba da se usklađuje sa Zakonom br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, odnosno članom 43, gde se radi o sednicama skupštine opštine i člana 44, o vanrednim sednicama skupštine opštine. takođe, treba da se usklađuje i sa Administrativim uputstvom MALS-a br. 02/2015 za održavanje sednica skupštine opštine, odnosno člana 5 tačka 5.3 za redovne sednice, člana 6 tačka 6.5 za vanredne sednice kao i člana 7 za urgentne sednice.</p> <p>Evidentirano kršenje - član 3.13, član 6.3 i član 6.10 poslovnika se upotrebljava kao "parlamentarna grupa"</p> <p>Zahtev za razmatranje zakonitosti- Zakon br. .03/L-072 o lokalnim izborima u Republici Kosov, ne priznaje imenovanje "parlamanetarna grupa". Ovaj termin sa zamenjuje sa izrazom" politički subjekat" kao što je definisano u Zakonu o lokalnim izborima u Republici Kosovo.</p>

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave, od Skupštine opštine i gradonačelnika traži da preduzimaju konkretne mere kako bi akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog vremenskog roka od 30 dana, od dana primanja zahteva za razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštini za dalja objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-10197/19 datë:16.4.2019



Npi - 01/114 datë: 26.4.2019

HYRËSIS - UJAZNA - INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA OF KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date 10.05.2019

Njësia organizative /	tit. i Lëndës	Shtojca	Vlera
-VI-	P-524		

RREGULLORE

E PUNËS SË KUVENDIT DHE KOMITETEVE

Me ndryshime sipas Vendimit të Kuvendit numër: Npi - 01/115, datë: 26.4.2019

Prill 2019

Duke u bazuar në nenin 12.2.b. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e rregullt, të mbajtur më 26.4.2019, aprovoi këtë:

RR E G U L L O R E

TË PUNËS SË KUVENDIT DHE KOMITETEVE

I. Dispozitat e përgjithshme

Oëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet udhëheqja dhe funksionimi i punës së Kuvendit dhe Komiteteve, duke përfshirë edhe kontrollin efikas financiar të Administratës Komunale.

Përkufizimi

Neni 2

Përkufizimet në këtë Rregullore:

Përkufizimet e termave janë të rregulluara me nenin 3 të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040 të Republikës së Kosovës.

II. Mbajtja e mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve

Mbledhjet dhe kuorumi

Neni 3

- 3.1 Kryesuesi duhet të thërrasë dhe të kryesojë mbledhjet e Kuvendit të Komunës. Kryesuesit e Komiteteve duhet t'i thërrasin dhe t'i kryesojnë mbledhjet e Komiteteve përkatëse.
- 3.2 Kryesuesi i Kuvendit apo i Komitetit mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme, në situatë të jashtëzakonshme, duke u bazuar në nenin 44 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-040.
- 3.3 Në mungesë të Kryesuesit, kryesimi i mbledhjes bëhet nga anëtari më i moshuar i Kuvendit, Komitetit, i pranishëm në mbledhje.
- 3.4 Së paku 7 ditë pune para çdo mbledhjeje të Kuvendit të Komunës, ose, ekskluzivisht, tri ditë pune më herët, në raste urgjente, anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën, vendin e mbajtjes së mbledhjes, si dhe rendin e ditës. Njoftimi publik për këtë duhet të shpallet në të njëjtën kohë në mjeteve të informimit publik, duke u bazuar në "Udhëzimin Administrativ të Ministrisë për Pushtetin Lokal, Nr.2008/09" për Transparencën në Komuna. Anëtarët e Komiteteve duhet të njoftohen për mbledhje, së paku, tri ditë pune më parë. Njoftimi për mbledhjet e Komiteteve përfshin kohën, datën dhe vendin ku mbahet mbledhja, si dhe rendin e ditës për atë mbledhje. Kryesuesi duhet të garantojë që këto kushte janë përmbushur për të gjitha mbledhjet e Komiteteve dhe të Kuvendit. Në të njëjtën kohë, ai duhet t'ia dorëzojë thirrjen për pjesëmarrje në mbledhje çdo anëtari të Kuvendit, Komitetit, së bashku me rendin e ditës, i cili përmban çështjet për të cilat do të diskutohet në mbledhje.

- 3.5 Kuvendi i Komunës dhe Komitetet e tij mbajnë mbledhjet e tyre në orar të rregullt, ashtu siç është caktuar me Statutin e Komunës.
- 3.6 Mbledhjet e Kuvendit gjithashtu mund të thirren nga 1/3 e numrit të anëtarëve të zgjedhur.
- 3.7 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve duhet të mbahet procesverbal dhe, nëse ekzistojnë kushtet teknike, edhe incizimi elektronik, në mënyrë që stenogrami t'u dërgohet delegatëve. Procesverbali duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje dhe të anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, çështjet, të cilat do të diskutohen, rezultatit numerik të votimit dhe propozimet e miratuara, apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret omri i secilit këshilltar, në procesverbal duhet shënuar si ka votuar secili. Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal i emëruar. Procesverbali duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Secili anëtar ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.
- 3.8 Secili anëtar që merr pjesë në mbledhje duhet të shënojë emrin e tij në listën e pjesëmarrësve, ose në listën për personat e pranishëm, të paraparë për këtë qëllim.
- 3.9 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve përbëhet nga një më tepër se gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- 3.10 Asnjë nga pikat e propozuara të rendit të ditës nuk do të shtrohen për diskutim në mbledhje pa miratimin e Kuvendit, përveç në raste (urgjente), të cilat do të konstatohen në procesverbalin e Kuvendit, Komitetit, si çështje me urgjencë.
- 3.11 Lista e prezencës së anëtarëve të Kuvendit, Komitetit, në mbledhje, dorëzohet për nënshkrim në fillim të mbledhjes.
- 3.12 Administrata vendos që Subjekti i cili ka fituar zgjedhjet të ketë mundësinë e pari të zgjedh rendin e ulëseve, ndërsa të tjerët të zgjedhin sipas numrit të votave të fituara.
- 3.13 Anëtarët e Kuvendit duhen të pajisen me kartela identifikuese, të cilat vendosen në një vend të dukshëm dhe të barten gjatë mbledhjes. Për formimin e Grupit Parlamentar vendos Kuvendi, ku do të kërkohet edhe pëlqimi nga subjekti politik përkatës, se kush e përfaqëson grupin parlamentar.

Pjesëmarrja e publikut në mbledhje

Neni 4

Përveç të drejtës së dhënë sipas Ligjit dhe Statutit të Komunës, pjesëmarrësit nga publiku mund ta marrin fjalën nga Kryesuesi në mbledhje për çështje specifike. Kryesuesi i mbledhjes duhet të kujdeset që diskutimi i tyre të mos zgjatë më shumë se tre minuta, t'i përmbahen rendit të ditës dhe të mos ketë përsëritje, për të cilat Kryesuesi ka të drejtë t'i ndërpresë.

Rendi i ditës dhe renditja e punëve

Neni 5

- 5.1 Propozimin e Rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit, Komitetit, e përgatit Kryesuesi në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.
- 5.2 Rendi i ditës në mbledhje zakonisht është:

- a. Konstatimi i pjesëmarrjes në mbledhje të anëtarëve të Kuvendit, Komitetit (kuorumi), pjesëmarrja e publikut dhe ekzekutivit të Komunës;
- b. Shqyrtimi (miratimi ose mosmiratimi) i procesverbalit të mbledhjes së fundit;
- c. Shqyrtimi i peticioneve;
- d. Punët që kryhen në mbledhje, të cilat parashihen në bazë të Rregullores, Statutit, ose ligjeve në fuqi;
- e. Çfarëdo çështje e shtruar nga Kryesuesi i mbledhjes dhe temat që shtrohen aty, cilado punë e papërfunduar në takimin e fundit;
- f. Raportet dhe rekomandimet e marra nga Komitetet dhe të gjitha çështjet e tjera që lindin si rezultat i raporteve;
- g. Propozimet dhe rekomandimet e drejtuara nga Drejtoritë që vijnë nga Kryetari;
- h. Çështjet që kanë të bëjnë me aktivitete të Komunës dhe të shtruara nga anëtarët, sipas rendit, ashtu si janë pranuar ato;
- i. Propozimet e shtruara nga anëtarët, sipas radhës së pranimit të tyre;
- j. Kërkesat e ndryshme për Kuvendin, përkatësisht Komitetet;
- k. Pika të ndryshme që, sipas mendimit të Kryesuesit, meritojnë të shqyrtohen në mbledhje.

5.3 Në mbledhje mund të vendoset që të punohet me rendin e ndryshuar të ditës .

5.4 Pasi Kryesuesi i Kuvendit, Komitetit ka përgatitur rendin e ditës, Shërbimi Profesional i Kuvendit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Administratë duhet:

- a) T'i dërgojë secilit anëtar nga një kopje të materialit, i cili përmban shënime lidhur me çështjet, të cilat do të shtrohen në mbledhje, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë elektronike.
- b) T'i njoftojë anëtarët se materiali është i gatshëm për tërheqje dhe se atë mund ta bëjnë gjatë orëve të rregullta të punës në zyrën e Shërbimit për punët e Kuvendit.

Rregullat e diskutimit

Neni 6

- 6.1 Nuk mund të diskutohet asnjë pikë e rendit të ditës, para se të aprovohet si propozim për diskutim në mbledhje.
- 6.2 Kur bëhen propozime për rendin e ditës, Kryesuesi i evidenton propozimet sipas renditjes atyre që e kanë marrë fjalën, ndërkaq në votim të parin e hedh Rendin e Ditës që ka ardhur me ftesën për mbledhje si propozim i Kryesuesit në bashkëpunim me Kryetarin, kështu që me aprovimin e propozimit të parë, propozimet e tjera nuk hedhen në votim.
- 6.3 Nëse dy ose më shumë anëtarë dëshirojnë të marrin fjalën, Kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen e diskutimeve. Anëtarët i drejtohen Kryesuesit të mbledhjes dhe gjatë diskutimit të tyre duhet t'u përmbahen çështjeve aktuale të mbledhjes. Gjatë diskutimeve u përparësi u jepet Kryetarëve të Grupeve Parlamentare. Për renditjen e Kryetarëve të Grupeve Parlamentare që kanë kërkuar fjalën, vendoset sipas numrit më të madh të anëtarëve që kanë grupet parlamentare në Kuvend.
- 6.4 Anëtarët mund të kërkojnë të flasin sipas renditjes, ose sipas shpjegimeve personale dhe diskutimet e tyre do të dëgjohen. Vendimi i Kryesuesit për renditjen, ose për pranueshmërinë e shpjegimeve personale, është vendimtar.

- 6.5 Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet dhënia e propozimeve të tjera, përveç:
- Ndryshimit të Propozimit;
 - Propozimit për të parandaluar çrregullimet;
 - Propozimit për të përjashtuar publikun dhe mjetet e informimit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 7.4 të Rregullores;
 - Propozimit për të kaluar në pikën me radhë të rendit të ditës;
 - Propozimit, i cili kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit;
 - Propozimit për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e ardhshme;
 - Propozimit për ndërprerjen e mbledhjes.
- 6.6 Kryesuesi në mbledhje nuk do të lejojë asnjë propozim, derisa të gjithë ata që dëshirojnë të diskutojnë për Propozimin e dhënë ta kenë bërë këtë për kohë të mjaftueshme, përveç nëse tërhiqen nga diskutimet e tyre.
- 6.7 Kur ndonjë anëtar e ka fjalën në mbledhje, të gjithë anëtarët e tjerë pjesëmarrës qëndrojnë ulur, të mbajnë qetësinë, dhe të kufizojnë përdorimin e telefonit.
- 6.8 Nëse ndonjë anëtar jep ndonjë propozim, ai ka të drejtë të marrë përgjigje nga zyrtarët kompetentë të drejtorisë përkatëse, menjëherë para se propozimi t'i nënshtrohet votimit.
- 6.9 Gjatë tërë kohëzgjatjes së mbledhjes, Kryesuesi duhet të respektojë parimin që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë diskutimi, të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje.
- 6.10 Kryetarët e Grupeve Parlamentare kanë në dispozicion pesë minuta për një diskutim, me të drejtë sqarimi edhe për 5 minuta shtesë, në diskutimin e dytë, brenda të njëjtës pikë, ndërsa për çështje që konsiderohen të rëndësishme, vendoset nga Kuvendi.
- 6.11 Anëtarët e Kuvendit kanë në dispozicion pesë minuta për një diskutim me të drejtë sqarimi edhe për 2 minuta shtesë, në diskutimin e dytë, brenda të njëjtës pikë.
- 6.12 Nëse gjatë diskutimit nga ndonjë anëtar i Kuvendit i përmendet emri anëtarit tjetër, ai ka të drejtë të replikojë jo më gjatë se dy minuta.
- 6.13 Kur ndonjë anëtar diskuton në mbledhje, ai duhet të jetë i qartë dhe i përgatitur dhe të mos i lejohet që të tejkalojë minutazhin e përcaktuar në nenin 6.10 dhe 6.11 të kësaj Rregulloreje.
- 6.14 Diskutimet e Ekzekutivit lidhur me informatat nuk votohen dhe nuk duhet të jenë më të gjata se 5 minuta.
- 6.15 Raportet nga Ekzekutivi, të cilat votohen nuk duhen të jenë më të gjata se 10 minuta. Për çështjet e tjera me rëndësi, vendos Kuvendi.
- 6.16 Për pyetjet e ngritura për pikat e rendit të ditës, Ekzekutivi ka në dispozicion, për secilën pyetje, një minutë, që të japë përgjigje me gojë, me përjashtim të pikës së rendit të ditës (Pyetje- Përgjigje), ku përgjigjet merren vetëm me shkrim.

Votimi

Neni 7

- 7.1 Votimi në të gjitha mbledhjet bëhet me ngritjen e dorës, ose në formë elektronike, nëse Kuvendi vendos që votimi të bëhet në mënyrë të fshehtë, ose kur aktet më të larta kanë paraparë mënyrë tjetër të votimit.

- 7.2 Para votimit, secili anëtar ka të drejtë të kërkojë që rezultatet e votimit të regjistrohen, ku do të shihen emrat e të gjithë anëtarëve që kanë votuar dhe emrat e atyre që abstenojnë.
- 7.3 Secili anëtar mund të kërkojë që në procesverbalin e mbledhjes të shënohet se si ai ka votuar për çështjen e caktuar, ose nëse ai ka abstenuar.
- 7.4 Kur ka nevojë të bëhet votimi i propozimit për emërimin ose zgjedhjen e ndonjë anëtari për pozitën, e cila duhet të mbulohet edhe nga Komuna dhe kur ekziston në dy ose më shumë kandidatë të propozuar për pozitën në fjalë, emrat e të gjithë të propozuarve paraqiten në mbledhje në formë të shkruar, sipas ranglistës së panelit intervistues, ose sipas radhës alfabetike të emrave të tyre.
- 7.5 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit, Komiteteve, secili anëtar ka nga një votë. Në rast të numrit të njëjtë të votave, Kryesuesi ka një votë shtesë, që mund ta përdorë "Për" ose "Kundër" ndonjë propozim, sipas nenit 48.1 të LVL – Nr.03/L-040.
- 7.6 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij merren me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm, të cilët votojnë, përveç nëse me Ligj, Statut ose Rregullore është paraparë ndryshe.
- 7.7 Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorumit, por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit.
- 7.8 Përgatitjet e fletëvotimeve, kutive të votimit si dhe ruajtja e materialit për së paku 1 (një) vit bëhet nga Drejtoria për Administratë, në bashkëpunim me shërbimin e Kuvendit.
- 7.9 Para fillimit të procesit të votimit të fshehtë, Kuvendi zgjedhë Komisionin Votues, i cili udhëheq me procesin e votimit, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe.
- 7.10 Propozimi, apo zgjedhja votohet menjëherë duke shënuar shenjat (X), (V) si dhe shenjën e rumbullakësimit (O) afër numrit rendor të kandidatit të preferuar dhe duke e hedhur votën në kutinë e votimit.
- 7.11 Rezultatet e votimit shpallen menjëherë pas numërimit të votave nga Komisioni Votues.
- 7.12 E drejta e pjesëmarrjes dhe e votimit u merret të gjithë delegatëve, të cilët kanë konflikt e interesi për pikën e caktuar, sikurse në votimin e hapur, ashtu edhe votimin e fshehur.

Kodi i mirësjelljes

Neni 8

- 8.1 Nëse Kryesuesi i mbledhjes konsideron se ndonjëri prej anëtarëve nuk sillet mirë në mbledhje, duke mos respektuar kërkesat e Kryesuesit, duke e penguar me dashje punën e mbledhjes, ose duke u sjellë në mënyrë ofenduese, atij duhet t'i tërhiqet vërejtja. Nëse sjelljet e anëtarit në fjalë vazhdojnë të jenë të pandryshueshme, Kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarë njëri prej këtyre masave, veçmas, ose si varg masash:
 - a. Anëtarit të Kuvendit i ndalohet diskutimi i mëtutjeshëm në mbledhje.
 - b. E udhëzon anëtarin e Kuvendit, Komitetit, të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përveç kur do të ketë votime;
 - c. Jep urdhërin që anëtari të largohet nga mbledhja, përveç kur do të ketë votime;
 - d. E shtyn mbledhjen për një orë ose deri në kohën apo datën që caktohet.

- 8.2 Nëse pjesëmarrësi në mbledhje nga publiku me dashje i ndërpret punët e mbledhjes, Kryesuesi i mbledhjes do t'ia tërheqë vërejtjen atij për mbajtjen e qetësisë. Nëse ai vazhdon të ndërhyjë në mbledhje, Kryesuesi i mbledhjes mund të ndërmarrë njëriën prej këtyre masave, veçmas, ose si varg masash:
- E udhëzoi pjesëmarrësin të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga mbledhja;
 - Jep urdhërin që pjesëmarrësi të largohet nga mbledhja;
 - E shtyn mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, apo datën që caktohet.
- 8.3 Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim më të madh, Kryesuesi i mbledhjes mund të urdhërojë që të gjithë ta lirojnë sallën e mbledhjes dhe mund ta shtyjë mbledhjen për një orë, ose deri në kohën, apo datën që caktohet.

III. Procedura e ndryshimit

Neni 9

Procedura e ndryshimit të Rregullores së punës duhet të jetë :

- Iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit, Komitetit, mund ta ndërmarrë 1/3 e Anëtarëve të Kuvendit, si dhe Kryesuesi i Kuvendit.
- Çdo propozim për ndryshimin e Rregullores së punës shqyrtohet nga Komiteti për Politikë dhe Financa, i cili duhet të dalë me rekomandime.

IV. Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 10

- Në rastet e konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale ose Statutin e Komunës, vlejnë dispozitat e aktit më të lartë.
- Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja e mëparshme e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Np1 – 01/43, datë: 03.11.2008.
- Rregullorja hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtëmës.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Braha